



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Datë 25/10/2023

PROCES VERBAL

Konsultimi për Buxhetin dhe Paketën Fiskale 2024

Vendi : Njësia Administrative Piskovë

Ora : 10:00

Tema e konsultimit : Buxheti dhe Paketa Fiskale 2024.

I mbajtur sot më datë 25 Tetor me pjesëmarrjen e Kryetares së Bashkisë, znj. Alma Hoxha, Kryetares së Këshillit Bashkiak, znj. Anila Dhimitri, nën/Kryetarit z. Florand Hasani dhe Administratorit të njësisë Piskovë zJuxhin Pasho. Gjithashtu pjesëmarrës janë palë të interesuara, subjekte dhe banorë të zonave përreth. Takimi u hap nga znj. Alma Hoxha e cila fillimisht falenderoi të gjithë të pranishmit. Më pas ajo u foli të pranishmëve për investimet e reja që priten të realizohen gjatë vitit të ardhshëm. Gjithashtu u tha se në vijim të muajit do të kryhet dhe procesi i zgjedhjes së Kryetarëve të Fshatrave. Në fund të fjalës znj. Alma Hoxha u prezantoi banorëve Kryetaren e sapovendosur të Këshillit Bashkiak.

Në vijim banorët paraqitën disa nga problemtikat më kryesore të zonave të tyre si :

- Urat e fshatit kërkojnë ndërhyrje po ashtu varrezat e fshatit kanë nevojë për pastrim.
- Rritje e sigurisë për pronat private pasi sulmohen vazhdimisht nga individë.
- Sistemim i vendgrumbullimit të mbetjeve në fshatin Piskovë.
- Zgjidhja e problemit të kasolleve afër banesave në fshatin Piskovë.
- Nevojë urgjente për të pastruar përrrenjtë e rrugës së fshatit Buhal.
- Zgjidhja e problemit të druve të zjarrit në fshatin Rapckë.
- Problematikë me çezmat ekzistuese të fshatit Rapckë.
- Rehabilitim i rrugës që të çon në fshatin Pagri.
- Problematika me ujin e vaditjes në fshatin Kosinë.

Kryetarja e Këshillit Bashkiak u tha banorëve se institucioni që ajo përfaqëson do të bëjë maksimumin për të ndërhyrë fillimisht atje ku është më e domosdoshme. Gjithashtu ajo shtoi se banorët duhet të jenë të vetëdijshëm se buxheti i Bashkisë nuk mund t'i përballojë të gjitha kërkesat dhe nevojat që hasen rrugës duke kërkuar nga ta mirëkuptim dhe durim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

Në fund të takimit znj. Alma Hoxha i siguroi banorët se së bashku me stafin e saj do të fillojë menjëherë nga puna për të parë ku mund të ndërhyet duke caktuar dhe disa nga problemet e paraqitura prej tyre si prioritete për investime. Më pas duke i falenderuar edhe një herë për bashkëpunimin e mirë që ekziston mes palëve si rrugën e vetme për të vazhduar më tej.

Konceptoi:

Koordinatori i Konsultimit Publik

Albion Naska

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Denisa DURO

Foto nga takimi:





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KOORDINATORI PËR KONSULTIMIN PUBLIK

